



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 474 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

**VENDIM Nr. 78, datë 20.03.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor "Gërmime arkeologjike dhe valorizim turistik i kishës paleokristiane në fshatin Hot (Malësi E Madhe)"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia E Studimeve Albanologjike), drejtues projekti Prof. Gëzim Hoxha, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor "Gërmime arkeologjike dhe valorizim turistik i kishës paleokristiane në fshatin Hot (Malësi E Madhe)"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia E Studimeve Albanologjike), drejtues projekti Prof. Gëzim Hoxha, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Kryerja e gërmimeve arkeologjike, konservim dhe valorizim të kishës paleokristiane në fshatin Hot
  - Konsolidim-restaurim dhe valorizim
  - Rrethim i thjeshtë i terrenit me kangjella dhe përgatitja e një sinjalistike turistike
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)

4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

---

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)